



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Nr: 02/2/59

Datë: 18.8.2020

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, në bazë të Rregullores Komunale për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, Nr.01-060/01-24495/17, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

PËR APLIKIM-MBËSHTETJE FINANCIARE ME SUBVENCIONE PËR OJQ – TË DHE SHOQATAT QË ZHVILLOJNË AKTIVITETE NË FUSHËN E INTEGRIMIT TË KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKANLI

Qëllimi i thirrjes për aplikim:

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare me subvencione për OJQ-të dhe Shoqatat për zhvillimin e aktiviteteve që i kontribuojnë komuniteteve rom dhe ashkanli në çështjen e punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, arsimit, strehimit dhe banimit dhe aktiviteteve kulturore dhe sportive rinore.

Të gjitha Organizatat Joqeveritare (OJQ-të) dhe Shoqatat të komuniteteve rom dhe ashkanli, të cilat ofrojnë shërbime të këtilla, mund të aplikojnë me projektpropozime për sigurimin e përkrahjes financiare me subvencione.

OJQ-të dhe Shoqatat të cilat aplikojnë me projekt propozime , duhet të përcaktohen vetëm në një pikë.

Projektet të cilat do të marrin përkrahje financiare duhet të kenë për objekt zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve të caktuara ashtu siç parashihet edhe me **PLANI LOKAL TË VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKANLI NË KOMUNËN E SHTIMES 2018-2021**

Kualifikimi dhe dokumentet për aplikim

OJQ-të dhe Shoqatat të cilat kërkojnë mbështetje me subvencione duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi, në Republikën e Kosovës.

OJQ-të dhe Shoqatat duhet të ofrojnë dëshmi për projektet e realizuara në të kaluarën dhe duhet të kenë kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve në fusha të caktuara që i kontribuojnë komunitetit rom dhe ashkanli.

Në projekt duhet specifikuar qartë qëllimi, objektivat, aktiviteti, përfituesit dhe buxheti,

përshkrimi i kapaciteteve menaxhuese të organizatës, personeli dhe përfshirja e ekspertëve në zbatimin e projektit.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

1. Kopja e letërnjoftimit të Drejtorit (Kryetarit) Ekzekutiv të OJQ-së apo Shoqatës;
2. Projektpropozimi;
3. Tabela e buxhetit të projektit;
4. Kopja e certifikates së regjistrimit të OJQ-së apo Shoqatës;
5. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
6. Kopja e xhirollogarisë së OJQ-së apo Shoqatës;
7. Kopja e Statutit të themelimit të OJQ-së apo Shoqatës;
8. CV-të e stafit të angazhuar në zbatimin e projektit;
9. Përparësi kanë OJQ-të dhe Shoqatat të cilat janë të licencuara për ofrimin e shërbimeve për komunitetin rom dhe ashkanli.;


Afati dhe procedura e aplikimit:

Afati për dorëzimin e Projektpropozimeve për mbështetje me subvencione është 15 ditë pune nga dita e shpalljes. Projektpropozimet me dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Zyrën e Komunale për Komunitete dhe Kthim, Objekti i Komunës, Zyra Nr.36, çdo ditë pune nga ora 8:00-16:00

Formularin për aplikim dhe informatat më të hollësishme rreth aplikimit mund t'i merrni në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.



Shefi i ZKKK-së,


Ibrahim Demiri